

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Prishtina në pritje të vendimit historik për ish-krerët e UÇK-së! Qytetarët mbushin sheshin "Skënderbeu", me flamuj në duar presin "ditën e re të lirisë"
ADRESA	https://newsbomb.al/rajon/prishtina-ne-pritje-te-vendimit-historik-per-ish-kreret-e-uk-s-e-qytetaret--i401293
BURIMI	newsbomb.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 20:14:07 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 19:53:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	f9e122819a5a25d6214e0a393352a92704e4d787d5cc8c1d4bc60588f502b748
TEKSTI	d31bc3c4825109a321b06d96cccc2ecd499e677f15c6164d50fef3c6e2fc5e93
PAMJA	eaaa21ba7a3e408d9a04cb0c0fefae5facc83bd3c9fece479e3f06e6285b5d8b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	bfd8b554e76c579048b16cea7557fc26d816cfd466d7bddd1f837068ab43bb06
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9dbe3bb033f14c903d871b5f44056dbb0c7543241b7df3ea5dc415a83f1a9da2
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/bfd8b554e76c579048b16cea7557fc26d816cfd466d7bddd1f837068ab43bb06

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

12 numrat e parë FALAS!
Version PDF

Abonohu te Revista

Kreu Politikë Aktualitet Ekonomi Kulturë & Art Rajon Sport Bota Showbiz SocialBomb



Çështjet kryesore

Arrestohet Ergys Agasi

"Retreat"-i i qeverisë në Pogradec!

SPAK godet grupin e Eldi Dizdarit dhe Dritan Gjikës

Rajoni

15 Shtator 2026, 21:53

Prishtina në pritje të vendimit historik për ish-krerët e UÇK-së! Qytetarët mbushin sheshin "Skënderbeu", me flamuj në duar presin "ditën e re të lirisë"



Shkruar nga Newsbomb



Presim "ditë e re të lirisë"

Në prag të 16 shtatorit, dita kur Dhomat e Specializuara në Hagë pritet të shpallin vendimin e shkallës së parë për ish-krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi, kryeqyteti ka marrë një atmosferë krejt tjetër.

Në sheshin "Skënderbeu" në Prishtinë tashmë është vendosur një ekran i madh për ndjekjen e drejtpërdrejtë të seancës nga Haga, janë shtruar qilima të kuq dhe janë vendosur flakadanë. Hapësira është përgatitur që qytetarët ta ndjekin së bashku momentin e shpalljes së vendimit.

Përgatitjet kanë ardhur pas thirrjes së organizatorëve të iniciativës "Liria ka emër" dhe aktivistit Çlirim Haziri, i cili u ka bërë thirrje qytetarëve që të mbledhen në shesh që në mbrëmjen e 15 shtatorit, për ta pritur së bashku mëngjesin e vendimit. Tashmë një numër i madh qytetarësh kanë filluar të mbledhen në qendër, ndërsa pamjet tregojnë një mobilizim të plotë.

Kjo është një ngjarje historike, emocionale dhe politike për Kosovën. Fundi i një procesi 5-vjeçar ku akuzat ndaj katër ish-krerëve të UÇK-së u konfirmua në tetor të vitit 2020. Që atëherë ata ndodhen në prangë në Hagë. Gjykimi ka zgjatuar me vite, është

Revista



Abonohu tani dhe lexoje >

Lajmet e fundit



Politikë

PSË ishte e pritshme lënia në qeli e Erlon Vellajt? Analist: Këmbëngulja për të qeverisur Tiranën nga burgu, i ka kushtuar qeverisë



Aktualitet

Dita e 108-të e "Revolucionit Flamingo", protestuesit e "shpërngulim" protestën te Mine Peza: Lironi qytetarët

Zbulu më shumë artikuj >

shoqëruar me shtyrje të afatit për shpalljen e vendimit dhe ka shkaktuar debat të madh në Kosovë. Gjykimi u mbyll më 18 shkurt 2026 dhe vendimi pritej brenda 90 ditëve, por u shty fillimisht për 20 korrik dhe më pas për 16 shtator.

Prokuroria i akuzon për përgjegjësi individuale dhe komanduese për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, përfshirë 102 vrasje, torturë, ndalim të paligjshëm dhe zhdukje të detyruara, të kryera ndaj të burgosurve në qendra ndalimi të UÇK-së në Kosovë dhe në veri të Shqipërisë gjatë viteve 1998-1999. Të katërt janë deklaruar të pafajshëm. Prokuroria ka kërkuar 45 vite burg për secilin.

Nesër pritet vendimi i shkallës së parë. Vetë Hashim Thaçi, në një intervistë për RTV Dukagjinin pak ditë më parë, është shprehur se pret pafajësi për të gjitha akuzat. Në anën tjetër, edhe nëse shpallen të pafajshëm për krime lufte, ata mund të mos lirohen menjëherë, pasi ndaj Thaçit zhvillohet edhe një proces tjetër për pengim të drejtësisë, ku prokuroria ka kërkuar 6 vite burg shtesë.

Qytetet në Kosovë kanë vendosur orë me numërim mbarsht për 16 shtatorin. Në Ferizaj, Prishtinë dhe qytete të tjera, iniciativa "Liria ka emër" ka vendosur instalacione të tilla si shenjë e pritjes për atë që e quajnë "ditë e re e lirisë".

Më 12 shtator, mijëra qytetarë u mbledhën në "Marshin për Liri" në Prishtinë me flamuj të Kosovës, Shqipërisë dhe emblemat e UÇK-së, në mbështetje të katër ish-krerëve.

Për një pjesë të madhe të popullit në Kosovë, Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi shihen si figura qendrore të luftës për pavarësi, ndaj vendimi konsiderohet si një "ngjarje tektonike" që do të ndikojë në politikën e brendshme dhe në raportet e Kosovës me Perëndimin.

Prandaj sheshi "Skënderbeu" sonte nuk është thjesht një vend ku është vendosur një ekran. Është kthyer në një hapësirë bashkimi, pritje dhe shprese kolektive për një vendim që shumëkush në Kosovë e sheh si gjykim ndaj vetë luftës së drejtë të UÇK-së.

Sondazh

Poll

Lexo gjithashtu



🕒 E Martë 20:34

Kosova "sy e veshë" nga Haga nesër, spitali kryesor i Prishtinës merr masa



Rajoni

TRAGJEDI në Venecia! Aksidenti me varkë "u pret jetën në mes" çiftit të sapomartuar, e reja shtatëzënë gjendet pas tre ditësh në ujërat e ftohta

E Martë 20:07

Rajoni

Sherri për borxhet "lau" me gj*k lagjen turistike në Stamboll, tre të vrarë dhe një i plagosur (PAMJE)

E Martë 19:03



E Martë 18:27 Newsbomb

Ditë historike për Kosovën! Gjykata e Hagës del nesër me vendim për ish-krerët e UÇK-së, zgjatet paraburgimi për Veselin dhe Krasniqin



Rajoni

"U ktheva të çliroj vendin!" Neo-nazisti Ilias Kasidiaris lë qelinë me plane të qarta: Nuk jam vetëm, një parti e re do jetë në Greqi

E Martë 15:28



Rajoni

Mbylli sytë sot në moshën 76-vjeçare, kush ishte Flora Brovina, gruaja që puthi tokën e Kosovës pasi u lirua nga serbët! Historia e një jete mes dhimbjes, luftës dhe qëndresës

E Martë 14:24



E Martë 11:41

Kosova në zi, ndahet nga jeta në moshën 76-vjeçare Flora Brovina



Rajoni

Ushtruan dhunë brutale ndaj një indiani, arrestohen dy shtetas shqiptarë në Greqi

🕒 E Hënë 21:36



Rajoni

Nga president në kryeministër, Aleksandër Vuçiç jep datën: Më 27 shtator do të jap dorëheqjen, i kam shërbyer me besnikëri Serbisë

🕒 E Hënë 21:01



Rajoni

🕒 E Hënë 19:21

U propozua dy javë më parë për President të Kosovës, Bekim Sejdiu tërhiqet nga kandidatura: Më ka munguar mbështetja parlamentare



Rajoni

Mes lotëve dhe dhimbjes, I jepet lamtumira e fundit nga miqtë dhe kolegët Giorgos Mazonakis

🕒 E Hënë 17:46



Rajoni

Tragjedi në jug të Greqisë, përmblytet varka me emigrantë, 1 i vdekur dhe 20 të zhdukur

🕒 E Hënë 15:21



Rajoni



🕒 E Hënë 15:18 Newsbomb

Seanca maratone për Thaçin dhe katër miqtë e tij, DATA e përafërt kur mund të çohen në qeli ose jo për bashkëpunim kundër drejtësisë



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.